

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 01.10.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.09.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik : **VB. TOFAJ**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i pendave të ujitjes në zona rurale**”, me Nr. të Prok: **632-21-5495-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-104-521**, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatorit Ekonomik **VB. TOFAJ**, e dt.27.09.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi i pendave të ujitjes në zona rurale**, me Nr. të Prok: **632-21-5495-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-104-521**, kundër **NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të , datës 23.09.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES i publikuar me datë: 23.09.2021;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **VB. TOFAJ**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi i pendave të ujitjes në zona rurale**, me Nr. të Prok: **632-21-5495-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-104-521**,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 01.10.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pretendimi juaj lidhur me Specifikimet teknike nuk qëndron, sepse një gjë e tillë nuk është kusht në dosjen e tenderit:

ANEks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendosë specifikim teknik që favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shumë operatorë ekonomik.

Referohuni në specifikimin teknik paramasa

Prandaj ky pretendim i juaji është i pabazuar;

-Pretendimi juaj lidhur me Deklaratën nën betim të Operatorit ekonomik "ING CONCEPT" sh.p.k., është i pabazuar sepsedeklarata në fjalë është e plotësuar dhe e vulosur:



Numri i Prokurimit: 632-21-5495-5-2-1 – Titulli Ndërtimi i pondave të ujitjes në zona rurale

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	INGCONCEPT SH.P.K
Adresa e plotë:	R. ZUAN HAPADILAT
I përfaqësuar nga:	
Emri:	LEOTRIM HADERGJULAT
Pozita:	DREKTOR
Nënshkrimi:	
Data:	08.09.2021
Vula:	

-Pretendimi juaj lidhur me listën e kontratave është i pabazuar, sepse lista në fjalë është plotësuar:

Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit

(duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit per kontrate)

(Ky Aneks eshte obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë

NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit te kontratës	Data e përfundimit te kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Nurmi i telefonit te Blerësit
1	Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Treboviq, Katun i Ri dhe Nabergjan në Komunën e Pejë	Kontraktuar: 13.09.2016	Përfunduar: 27.10.2017	179,890.70	Komuna Pejë	E-mail: elmane.selimi@rks.gov.net	038-200-43-405
2	Ndërtimi i urës në rrugën Petro Nini Luarasi në Gjakovë	Kontraktuar: 10.11.2015	Përfunduar: 2017	67,326.10	Komuna Gjakovë	E-mail: elbana.bakalli@rksi.gov.net	3820044041
3	Asfaltimi i rrugëve në fshatrat RADAVC (Rrugët : Elezaj , Dem Allajaj , Osmon Zekaj , Hetem Fezaj , Hasan Tafa , E Beqejrajve , Xhuraj dhe E Minoriteteve) në Komunën e Pejë	Kontraktuar: 13.09.2016	Përfunduar: 26.10.2017	171,660.00	Komuna Pejë	E-mail: elmane.selimi@rks.gov.net	038-200-43-405
4	Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Trestenik (rruga e Berishëve 1 dhe 2, rruga afër varrezave) dhe Lutugllavë (rruga Trestenik - Lutugllavë dhe rruga Kër Sadria) në Komunën e Pejë	Kontraktuar: 22.08.2016	Përfunduar: 19.06.2017	166,296.90	Komuna Pejë	E-mail: elmane.selimi@rks.gov.net	038-200-43-405
5	Asfaltimi i rrugëve Hysni Rama dhe Mihajlo Pupin si dhe anekset e rrugës Beteja e Koshares , Ruzhdi Haxhi (anekset) dhe asfaltimi i disa rrugëve në Komunën e Pejë	Kontraktuar: 05.10.2016	Përfunduar: 2018	133,362.89	Komuna Pejë	E-mail: elmane.selimi@rks.gov.net	038-200-43-405
6	Asfaltimi i rrugëve Mbreti Zog dhe Eliot Engel dhe Kubezimi i parkingut pranë Cerdhes ne Peje	Kontraktuar: 17.06.2016	Përfunduar: 2017	21,727.70	Komuna Pejë	E-mail: elmane.selimi@rks.gov.net	038-200-43-405
7	Ndërtimi i Poligoni Sportiv në Shkollën fillore "Bajram Curri" në Strelle të Epërme, Deçan	Kontraktuar: 25.07.2019	Përfunduar: 05.2018	61,935.36	Ministria e Kulturës dhe Sportit (MKRS)	Email: prokurorimimkrs@gmail.com	38138211



-Pretendimi juaj lidhur me listën e punëtorëve dhe atë se z. Skender Mehmeti, është punëtorë i juaji dhe se të njëjtin e ka prezantuar edhe Operatori ekonomik "ARFA GROUP" sh.p.k. nuk qëndron, sepse operatori në fjalë, ka prezantuar listën prej 29 punëtorëve, mirëpo kontratat i ka prezantuar vetëm për 10 punëtorët e parë që d.m.th. se për të gjithë punëtorët tjerë nga numri 11 e më poshtë nuk janë prezantuar kontrata por të njëjtët vetëm figurojnë në atë listë dhe këtë Autoritetin kontraktues nuk e konsideron shkelje dhe nuk e ka pa të arsyeshme të kërkoj sqarime shtesë se pse z. Skender Mehmeti figuron në listën e tyre dhe tuajen, prandaj pretendimi juaj është i pabazuar;

-Pretendimi juaj lidhur me mini eskavatorin gjithashtu nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues, në FDT, nuk e ka precizuar se pesha a duhet të jetë NETO apo BRUTO deri në 3.5ton, prandaj këtë diferencë prej 150kg në peshën bruto, Autoriteti kontraktues e ka konsideruar si devijim të vogël.

-Pretendimi juaj lidhur me kohëzgjatjen e sjelljes së betonit është i pabazuar, sepse për Autoritetin kontraktues e rëndësishme është që Operatori ekonomik t'i përmbahet kushteve dhe cilësisë së punimeve sipas kontratës.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara
Arkivit të Komunës

z.Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

